



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË



Data: 10.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndërtim Lere Plastmasi dhe korita betoni në Kullotë “Qafa e Martës” Ekonomia kullosore Sherrë-Panarit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për rezervuarë 45247270-3

VLERA E FONDIT LIMIT:

5,770,436 (pese milion e shtateqind e shtatedhjetë mijë e katerqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **BASHKIA KORÇË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40 % e vlerës** së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në **ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat**, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje **Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”**: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.*

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më e vogël se 30 %** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Lidhur me dokumentacionin e kerkuar per vertetimin e puneve te ngjashme janë kerkuar keto dokumenta ne perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

Ne kuader te vleresimit te ofertave ne menyre sa me te drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontrates se bashkepunimit apo marreveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit te nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Dokumenta keto te nevojshme per te vleresuar lidhur me punet konkrete qe ka kryer OE si anetar i BOE,apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
N.P – 1	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P - 9	A	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime

N.S – 18

A

Punime topogjeodezike

N.P – 12

A

Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga specialisti i fushës ing Theodhor Kosti i argumentuar në procesverbalin e mbajtur prej tij date 09.07.2026 si më poshte:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridik që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P – 1	Punime gërmimi në tokë.	Gërmim dheu me krahë, në tokë mesatare, në seksion të lirë, kategoria e III dhe transport me karro dore deri 10 m Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak, me krahë, çdo 20 cm, në tokë të zakonshme. Rrafshim skarpatesh, me krahë, në gërmim, në tokë të zakonshme Transport zhavorri, çakulli me kafshë, në	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve të parashikuara në preventiv dhe që përfshihen në këtë kategori është:

		distancë 0.5-1 km Shoshitje dheu (shosha me vrima 2 x 2 cm) Transport dheu me karro dore, në distancë deri 10 ml Transport gurësh me karro dore, në distancë deri 10 ml Transport gurësh me kafshë, në distancë 0.5 - 1 km Hedhje dheu me lopatë, në tokë të butë		4,700,529.34
N.P- 9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime	Prodhim gurësh me krahë, kur në sipërfaqje ka mesatarisht gurë Përgatitje me krahë e betonit M-300 Hedhje betoni me krahë Shtresë kalldrëmi me gurë kave, me trashësi 20 cm. Shtirim plastmasi me dy shtresa, formimi i tegelit me 5 palosje (gjerësi 6-8 cm per çdo palosje) dhe fiksimi i tij me mjete rrethimore Ndërtim pusete prej betoni (për 1 m3 beton) M-300, ku përfshihen ndërtimi armaturës prej druri, vendosja e hekurit ose rrjetës prej teli, përgatitja e betonit, betonimi dhe dizarmimi Tubo plastike d = 50 m/m <i>Zërat e punimeve të përfshira në këtë preventiv kanë të bëjnë me hapjen e gropave (lera) që do të shërbejnë për pirjen e ujit të mbledhur nëpërmjet rrjedhjes së ujërave natyrale nga bagëtitë që do të kullosin.</i> Punimet e parashikuara për këtë objekt përfshihen në përshkrimin e përcaktuar për këtë kategori të licences si më poshtë: <i>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.</i>	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve të parashikuara në preventiv dhe që përfshihen në këtë kategori është: 795,124.24
N.S-18	Punime topogjeod ezike	Është kërkuar për arsye të zbatimit të rilevimeve topografike të domosdoshme gjatë zbatimit	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve të parashikuara në preventiv

				dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.P-12	Punime të inxhinieris ë së mjedisit.	Qëllimet e këtij projekti janë të arrihet shfrytëzimi sa më i mirë i kullotës nëpërmjet plotësimit të nevojave për ujë të pijshëm të blegtorisë nëpërmjet ndërtimit të veprave ujëpirëse (lerave). Punimet e parashikuara për këtë objekt përfshihen në përshkrimin e përcaktuar për këtë kategori të licences si më poshtë: <i>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.</i> <i>Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekulibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karierave dhe mbetjeve inerte.</i>	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

➤ **Inxhinier Hidroteknik** **1 (nje)**

Per te vertetuar personelin kryesor duhet:

I.Diploma

II- Kontrata e punes

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.2.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

➤ **1.Inxhinier Topograf 1(një)**

Dokumentacioni që duhet të paraqesin.

I. Diploma

II- Kontrata e punes

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

➤ **Teknik ndërtimi -1 (një)**

Për stafin e sipërcituar të paraqitet:

I.Kontrata e punes

II. Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi kerkesat 2.2.3, 2.2.4 dhe 2.2.5: Keto kriteret u vendosen nga specialisti i fushes ing Theodhor Kosti i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij date 09.07.2026 si me poshte:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se

licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar.

Me anë të këtyre kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kerkesa per drejtuesin teknik “Inxhinier Hidroteknik” Eshte vendosur duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier“, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar.

Bazuar ne zerat e punimeve te parashikuara ne preventiv nevojitet nje drejtues teknik me profesion ing hidroteknik i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

- Inxhinieri topograf është kërkuar me qëllim realizimin e rlevimeve topografike te domosdoshme gjatë zbatimit.
- Tekniku i ndërtimit është kërkuar për zbatimin e punimeve të ndërtimit sipas preventivit.

2.2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **38 persona**, dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion me kapacitet mbartës deri në 5 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira

Eskavator me zinxhir	Cope 1	ne pronesi ose me qira
----------------------	--------	------------------------

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike duhet te paraqiten dokumentat si më poshtë

Në rast se është në pronësi duhet të paraqiten: çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

Në rast se është me qera duhet të paraqiten: kontrata e qirasë vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me çertifikatën e pronësisë, lejën e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

(Ne rastin e mjeteve te marra me qira nga operatorët ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022, referuar dokumentacionit (leje qarkullimi, çertifikate e transportit te mallrave), mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi per kërkesat 2.2.6 dhe 2.2.7: Keto kriteret u vendosen nga specialisti i fushes ing Theodorh Kosti i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij date 09.07.2026 si me poshte:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

Numri **prej 38 personash** personash përfshin personelin kryesor drejtues teknik, specialiste dhe punëtorë të thjeshtë të përllogaritur nga zbërthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e

punimeve në ndërtim dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" dhe gjithashtu edhe bazuar edhe në rekomandinë e APP Nr 1797/1 datë 10.03.2022 janë parashikuar orët e punës për secilin zë punimesh dhe bazuar edhe në afatin e percaktuar në grafikun e punimeve është percaktuar numri minimal i punonjesve të domosdoshëm për realizimin e punimeve.

Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushës rezulton se :

Sasia totale e oreve të punës sipas manualit dhe analizave teknike për çdo zë të preventivit është 18,395.3 ore. Llogaritja e numrit të punonjesve në varesi të oreve të punës dhe afatit të kontratës është si më poshtë:

Totali orë pune + ore makineri	18,395.3
Ditë pune (orë pune/8)	2299.4
Nr. i punëtorëve (ditë pune/22 ditë)	35
Ing.hidroteknik	1
Ing. topograf	1
Teknik ndërtimi	1
Numri i punëtorëve gjithsej	38

Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike:

Ky kriter u vendos me qëllim që të vërtetohet se operatori ekonomik ka mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës për arsye se në preventiv është parashikuar zeri transport dheu” Bazuar në nenin 28 të Udhëzimit Nr.15, datë 24.7.2007 "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR" i ndryshuar, "Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit."

Lloji i Makinerive	Sasia	Argumentimi
Kamion me kapacitet mbartës deri në 5 ton	Cope 1	Nevojitet për transportin e materialeve ndërtimore
Eskavator me zinxhir	Cope 1	Nevojitet për punimet e gërmimit

Argumentimi i specifikimeve teknike

Dokumentacioni teknik ku janë përfshirë projektet, specifikimet teknike, preventivat e punimeve dhe afati i kryerjes të shërbimit për këtë objekt janë hartuar nga Grupi i Punës.

Dokumentacioni teknik ku janë përfshirë projektet, specifikimet teknike, preventivat e punimeve dhe afati i kryerjes të shërbimit, janë hartuar bazuar në: Ligji nr 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronesi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-Komunave/Bashkive", i ndryshuar, VKM nr. 839, datë 30.12.2025 "Për miratimin e normave,

standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira në fushën e pyjeve”, VKM nr. 776, datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe VKM. Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Gjatë hartimit të specifikimeve teknike janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit.

Llogaritja e fondit limit është bërë bazuar në VKM nr. 839, datë 30.12.2025 “Për miratimin e normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira në fushën e pyjeve”, VKM nr. 776, datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe VKM. Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Bazuar në ligjin nr 57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, mbas hartimit të projekteve përkatëse preventivave dhe analizave të çmimeve, ky dokumentacion është dërguar paraprakisht për miratim në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve me shkresën Nr. 5381, datë 25.05.2026.

Me shkresën Nr 592/1 datë 10.06.2026 të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, protokolluar në Bashkinë Korçë, me Nr 5381/1 datë 15.06.2026, Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka miratuar zbatimin e këtyre projekteve.

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili është publikuar se bashku me dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT